



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:040053

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05546485

P.2022:040054

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtëse Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurit M.I, i shpallur fajtor për veprën penale Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me numër PP/II.nr.250/2022 datës 24.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, më datë 07.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdulla Abedini, të pandehurit, më datë 08.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: M.I nga fshati ... rruga “..”, Komuna e Kaçanikut, i lindur me datë ..., nga i ati M...dhe e ëma H...e gjinisë M., i martuar, me numër personal ..., i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i tre fëmijëve, gjendja e dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 15.02.2022, rreth orës 15:50, në vendin e quajtur "Llokme", Kaçanik, i pandehuri me qëllim të vjedhjes së trungjeve në pyllin publik, është takuar nga roja e pyllit duke prerë drurë pa leje me sharrë motorike të cilat kishte për t'i bartur me tre kuaj me samar, dhe atë: pesëdhjetë (50) copë drurë të llojit qarri, me diametër 8-14 cm, me lartësi 8 m, me vëllim të përgjithshëm prej 2,50 m³, me ç'rast të dëmtuarës Komuna e Kaçanikut - Sektorit të pylltarisë i ka shkaktuar dëm material në vlerë 320,00 €.

-Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së .

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364, 452, 462 të KPP-së, të pandehurin e:

GJYKON

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditëve (Gjashtëdhjetë ditëve), i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar – Komunës së Kaçanikut, t'ia paguaj dëmin në shumë 320€, në afat prej 30 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Obligohet i pandehuri që për shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën 50.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të pandehurit M.I, ka ngritur aktakuzën P/II.nr.250/2022 datës 24.02.2022 për shkak të veprës Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata në bazë të nenit 280 të KPP-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor, më datën 07.03.2024.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësorë

Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare konform nenit 351 të KPPK-së, ka deklaruar: pas administrimit të provave në qeshtjen penale kundër te pandehurit M.I i akuzuar per veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, mbetem ne tërësi pranë aktakuzës, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar roja e pyellit Xh.T i cili ka deklaruar se të pandehurin e ka takuar në vendin e ngjarjes duke prer dru me sharrë motorrike dhe kishte qenë së bashku me kolegun e tij A.Rr, i pandehuri kishte pasur me vete edhe 3 kuaj me samarë të cilat i kishte prerë me sharrë motorrike, faktin se i pandehuri më datë 15.02.2022 është zënë ne vendin e ngjarjes ku i kishte prer drunjet, e vërteton edhe dëshmitari – roje e pyellit A.Rr në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor, andaj në bazë të këtyre provave i ka propozuar gjykatës qe te njëjtin te shpalle fajtor dhe ti shqiptoj nje sanksion penale të paraparë me ligj me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjykata me rastin e caktimit te lartesis se dënimit ti marre parasysh te gjitha rrethanat renduese ne pajtim me nenin 69 te KPK-së.

- I pandehuri e ka shqyrtuar të drejtën që të mbrohet në heshtje, por në fjalën përfundimtare se e vërteta është se me rojën e pyllit jamë takuar në rrugë dhe i kamë pasur dy kuaj.

Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

- Në cilësinë e dëshmitarëve janë dëgjuar rojet e pyllit të DAPK-Kaçanik: 1. Xh.T dhe 2. A.Rr.
- Në fazën e administrimit të provave janë lexuar: fletparaqitja e rojës se pyllit me numër të ditarit 07/22 e datës 15.02.2022.

Nuk ka pasur pyetje dhe vërejtje në provat e administruara nga palët.

Vlerësimet dhe gjetjet nga ana e gjykatës

Gjykata në bazë të provave të administruara në shqyrtim gjyqësor ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, si në mënyrë, kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat që janë administruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor ku pas analizimit të të gjitha këtyre provave një nga një dhe të gjitha bashkërisht, ka ardhur në këto përfundime:

Faktet jo kontestuese të rastit

Pasi që i pandehuri është mbrojtur në heshtje të gjitha faktet kanë qenë kontestuese

Faktet kontestuese të vërtetuara

1. Gjykata nga dëshmia e dëshmitarve – Rojeve të pyllit të DAPK-Komuna e Kaçanikut, Xh.T dhe A.Rr, të dhënë në shqyrtim gjyqësor, i ka vërtetuar disa fakte vendimtare:

1.1 Është vërtetuar fakti se rojet e pyllit Xh.T dhe A. Rr., më datë 15.02.2022, kanë qenë në orar të punës, në territorin e Kaçanikut 1 dhe Kaçaniku 2, në regjionin ekonomik pyjor

Kaçaniku 1 dhe Kaçaniku 2, në vendin e quajtur Llokme, të cilën e ka menaxhuar Komuna e Kaçanikut.

1.2 Është vërtetuar fakti vendimtar se i pandehuri më datën 15.02.2022, rreth orës 15:50, ka qenë në vendin e quajtur “Llokme”, në rajonin ekonomik-pyJOR Kaçanik, të cilin e ka menagjuar Komuna e Kaçanikut, lidhur me këtë Dëshmitari Xh.T gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka dëshmuar- citoj “*Më datë 15.02.2022 kam qenë në vendin e quajtur “Lokme”, e kam takuar në vendin e ngjarjes M.In*”, këtë fakt e ka konfirmuar edhe roja tjetër i pyllit A.Rr. Identifikimin e të pandehurit e kanë bërë rojet e pyllit pasi që të njëjtit të pandehurin e kanë njohur edhe më parë, ku roja e pyllit Xh. T. ka deklaruar citoj “*M... e kame njohur sepse ka pasur fletparaqitje edhe me herët*”

1.3 Pasi që është vërtetuar identiteti i të pandehurit, po ashtu është vërtetuar edhe se i pandehuri i kishte prerë drutë njoma (freskëta), me sharrë motorike, pa leje dhe atë: pesëdhjetë (50) copë drurë të llojit qarri, me diametër 8-14 cm, me lartësi 8 m, me vëllim të përgjithshëm prej 2,50 m³ të cilat ishte i përgatitur për t’i bartur me 3 kuaj samari.

Gjykata dëshminë e dëshmitarëve Xh.T dhe A. Rr. të dhënë në shqyrtim gjyqësor e vlerësoi si të besueshme, për faktin se të njëjtat ishin në përputhje të plotë me njëra tjetrën si dhe me me provat tjera të administruara si **fletparaqitja e rojës se pyellit me numër të ditarit 07/22 e datës 15.02.2022.**

2. Faktin se drunjtë të cilët ishin prerë nga të pandehurit ishin në vëllim të përgjithshëm 2.50 m³ dhe në vlerë prej 320€, gjykata e vërtetoi nga Fletëparaqitja e rojtarit të natyrës me numër **ditarit 07/22 e datës 15.02.2022** në të cilën është bërë llogaritja në kubaturë e drunjëve të prera si dhe vlera e dëmit, ku si pjesë e sajë është edhe procesverbali i komisionit të ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit, e llogaritur sipas çmimoreve të përcaktuara në rregulloren e MMPH Nr.1-15 për shërbimet e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe institucioneve të sajë.

3. Gjykata e analizoi dhe vlerësoi edhe provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor fletparaqitja e rojës se pyellit me numër të ditarit 07/22 e datës 15.02.2022, të njëjtën e vlerësoi si të besueshme për faktin se e njëta ishte në përputhje të plotë me dëshminë e rojeve të pyllit Xh.T dhe A. Rr. të dhënë në shqyrtim gjyqësor.

4. Gjykata ka vlerësuar se nuk pasur asnjë provë kundërthënëse në raport dhe lidhshmëri me njëra tjetrën.

5. Faktin se i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, gjykata e vërtetoi se i njëjti i kishte prerë trungjet në pyllin publik r dhe nuk ka pasur leje për prerjen e drunjtëve, e cila është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarëve Xh.T dhe A. Rr. të dhënë në shqyrtim gjyqësor.

5. Vlerësimi i mbrojtjes së të pandehurit, i pandehuri e ka shfrytëzuar të drejtën që të mbrohet në heshtje.

Elementet e veprës penale

Në nenin 349 paragrafi 1 të KPRK-së parashihet se: *“Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me.....*

1. Kjo vepër penale është kryer në pyllin publik, dhe e njëjta ka qenë nën autoritetin e Komunës së Kaçanikut ky fakt - vendi i prerjes së drunjtëve është vërtetuar nga dëshmia e Xh.T dhe A. Rr. të dhënë në shqyrtim gjyqësor.

2. I pandehuri kishte prerë drurë pa leje me sharrë motorike, dhe atë: pesëdhjetë (50) copë drurë të llojit qarri, me diametër 8-14 cm, me lartësi 8 m, me vëllim të përgjithshëm prej **2,50** m³, të cilat ishte i përgatitur për t'i bartur me 3 kuaj, me ç'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej **320 €,-ky** fakt është dëshmuar nga dëshmia e dëshmitarëve- rojeve të pyllit Xh.T dhe A. Rr. të dhënë në shqyrtim gjyqësor të cilët i kishin identifikuar, numëruar dhe matur trungjet e prerë, ndërsa llogaritja e sasisë është bërë nga komisioni i ekspertëve.

Gjykata vlerëson se me veprimet e të pandehurit, plotësohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje Pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK -së.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit duke u bazuar në nenet 69, 70 të KPRK-ës, ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë: gjendjen e varfër ekonomike-familjare të deklaruar nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se i pandehuri është recidivist i lojit dhe natyrës së njëjtë të veprave penale, i gjykuar me Aktgjykimin: 2022:064765 të datës 22.01.2024, i gjykuar me dënim me kusht dhe si dëmtues i rregullt i pyllit publik, i denuar me një numër të lartë të veprave kundërvajtëse të kësaj natyre:2 021:149162, 2021:153972, 2021:245836, 2021:267370, 2021:287021, 2022:021296, 2023:087978, 2023:143494.

Sipas vlerësimit të Gjykatës dënimi i shqiptuar me burgim ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, Gjykata ka vlerësuar se konform nenit 45 të KPRK-së, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPRK-ës, gjykata ka vendosur që të pandehurit ti obligoj që t'ia paguajnë palë së dëmtuar dëmin në vlerë 320€ duke u bazuar në Fletëparaqitja e rojtarit të natyrës me nr.165/2021, dhe numër të ditarit 76/21 e datës 20.11.2021 në të cilën është bërë llogaritja në kubaturë e drunjëve të prera si dhe vlera e dëmit, ku si pjesë e sajë është edhe procesverbali i komisionit të ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit, e llogaritur sipas çmimoreve të përcaktuara në rregulloren e MMPH Nr.1-15 për shërbimet e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe institucioneve të sajë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 364, 452, dhe 463 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2022040054:, datë 04.04.2024

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.